



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, kryesuesi i Kuvendit të Komunës

th ë r r e t

mbledhjen e **katërt** të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila do të mbahet më **02.05.2019** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, rr. “UÇK”, nr. 2.
Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 janar – 31 mars 2019 (TM1);
3. Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës (PMQU);
4. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, 01. nr. 046-295921, të dt. 06.12.2016, të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Qendrës së Arteve të Kosovës;
5. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ilir (Ajet) Sogojeva, Sabri (Ajet) Sogojeva, Ajet (Sami) Sogojeva, Albulena (Sami) Sogojeva dhe Agron (Sami) Sogojeva;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Salih (Hamdi) Berishës;
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Visar Sylejmanit;
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Azemine (Hamit) Gashit;
10. Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të Projektregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve;

Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://www.prishtina-komuna.org>

11. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
12. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e tarifave për transport të pacientëve dhe caktimin e tarifave për qytetarët jorezidentë të Prishtinës;
13. Pyetje dhe përgjigje;
14. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-060/01-91440/19, më 19.04.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://www.prishtina-komuna.org>